




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. _____
 Dep. _____
 Nr. i faq. _____
 Broj stranica _____
 Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
 Br. Prot. _____
 Prot. No. _____
 Data _____
 Datum _____
 Date _____

PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.10.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2402/17 për z. Blerim Ibrahim – Drejtor i Departamentit për Rezervat Shtetërore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Kosovës, për shkak se ai tashmë nuk ushtron këtë funksion dhe nuk gjendet në mesin e zyrtarëve të lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur, me nr. protokoli AKK-03-02-2402/17 për Zyrtarin e lartë, z. Blerim Ibrahim Drejtor i Departamentit për Rezervat Shtetërore në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) në Qeverinë e Kosovës, ka qenë një situatë e dyshuar me konflikt interesi për shkak se gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik zyrtarët e lartë nuk kanë të drejtë që njëkohësisht të ushtrojnë edhe funksion menaxhues në ndërmarrje private.

Agjencia kundër Korrupsionit e ka hapur rastin si rast të dyshuar, por gjatë procesit të hetimit është konstatuar se z. Ibrahim ka qenë vetëm ushtrues detyre dhe ndërkohë është larguar nga funksioni i Drejtorit të Departamentit për Rezervat Shtetërore në MTI (DPK/03-02/3568/17) dhe tani ai nuk e ushtron këtë pozitë, që rrjedhimisht do të thotë se nuk është as në mesin e zyrtarëve të lartë publik. Me rrethanat aktuale kjo situatë nuk paraqet as lëndë hetimi, sepse aktualisht i njëjti nuk ushtron asnjë funksion tjetër që e klasifikon atë në mesin e zyrtarëve të lartë publik, dhe si rrjedhojë nuk kemi të bëjmë me konflikt interesi të kësaj natyre.


II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtore e Agjencisë kundër Korrupsionit



/ Shaip Havolli /

